## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

1. Sipermarresi mban pergjegjesi per demtimet qe mund te ndodhin ne territorin e objektit qe ruhet nga ana e tij kur keto vijne si rezultat i mungeses se vigjilences te rojeve dhe mos organizimit te mire te sherbimit. Ne keto raste sipermaresi detyrohet te beje zhdemtimin e pasurise se demtuar ne masen 100% te vleres se demtuar.
2. Punonjesit e shoqerise duhet te jene te pajisur me uniforme me siglen dalluese te shoqerise.
3. Punonjesit e sherbimit duhet te dorezojne librin e punonjesit te sherbimit

***SHPERNDARJA***:

| Objektet qe do te ruhen | Nr i Rojeve | Nr I vend | Nr i Turneve |
|---|---|---|---|
| Korpusi kryesor | 5 | 1 | 3 |
| Urgjenca | 5 | 1 | 3 |
| Godina Sanatoriumit | 5 | 1 | 3 |
| Poliklinika | 5 | 1 | 3 |
| Nr Total i rojeve | 20 | 4 | |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Vendi dhe dorezimi i sherbimeve: Spitali Rajonal Shkoder.

1. Sherbimet do te kryhen per 24 ore me roje ne: Spitalin Rajonal Shkoder (me kater vend roje me tre turne)

2. Te mbuloje te gjitha shpenzimet si paga e rojeve,sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve, shpenzimet per uniformat, armatime, nderlidhje si dhe te gjitha kompesimet e tjera te njohura me ligj.

3. Sigurimi i rendit dhe qetesise ne objektet qe ruan, duke parandaluar demtimin e prones se punedhenesit ose vjedhjen e saj,duke informuar në kohë strukturat e Policisë së Shtetit si

dhe të sigurojë bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë publike në territorin e objektit në ruajtje;

4. Te kerkoje zbatimin e rregullave te percaktuara nga punedhenesi si dhe te rregulloreve te brendshme te nxjerra nga ky i fundit te cilat do te jene pjese perberese e kesaj kontrate.

5. Te informoje rregullisht titullarin e institucionit per shkeljet e konstatuara.

6. Sipermarresi mban pergjegjesi per demtimet apo vjedhjet qe mund te ndodhin ne territorin e objektit qe ruhet nga ana e tij kur keto vijne si rezultat i mungeses se vigjilences se rojeve dhe te mosorganizimit te mire te sherbimit. Ne keto raste sipermarresi detyrohet te bej cdemtimin e pasurise se vjedhur apo te demtuar ne masen 100% te vleres se demtuar.

7. Demtimin e vlerave materiale gjate shoqerimit prej tyre duke bere zhdemtimin 100% te vleres se demtuar si dhe pergjegjesine per jeten e personave qe bejne shoqerimin e mjeteve monetare.

8. Para marrjes se sherbimit, kontrollon objektin ne prezence te rojes dorezuese dhe per crregullimet e konstatuara njofton pergjegjesin e rojeve duke bere shenimet perkatese ne librin e sherbimit.

9. Ne rast zjarri merr masa per shuarjen e tij dhe menjehere njofton zjarrefikset.

10.Të marrë masat e nevojshme për sigurimin teknik në lidhje me **armët dhe municionet,** mjetet e shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi;

11.Të mos punësojë në veprimtarinë e SHPSF-së punonjës shërbimi të pacertifikuar;

12.Të përdorë aktivitetin e SHPSF-së vetëm për qëllimin për të cilin është licencuar;

Gjithashtu, operatori ekonomik në ushtrimin e aktivitetit të shërbimit privat të sigurisë fizike, duhet të ketë personelin kryesor si **Drejtuesin Teknik dhe Punonjësit e Shërbimit (rojet)** me detyrat përkatëse:

- Të ketë **drejtues teknik të liçensuar** për ushtrim aktiviteti.

Në bazë të ligjit nr.75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" drejtuesi teknik i SHPSF-së, ndër të tjera kryen këto detyra:
**a)** harton rregullat e funksionimit të SHPSF-së, në lidhje me ruajtjen e objektit;
**b)** është përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe siguron bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje;
**c)** ka përgjegjësinë të konstatojë dhe të analizojë të metat e dobësitë e punonjësit të shërbimit, t'ua bëjë ato të njohura administratorit dhe strukturave vendore të Policisë së Shtetit, si dhe të marrë masa për shmangien dhe përmirësimin e tyre;
**ç)** jep masa disiplinore ndaj punonjësit të shërbimit, sipas kuptimit të këtij ligji;
**d)** parandalon planifikimin në shërbim të punonjësit të papajisur me uniformë, armatim dhe pajisje shërbimi;
**dh)** merr masa për ruajtjen e vendit të ngjarjes, në rastin kur ndodh një vepër penale në territorin e objektit që ka në ruajtje, duke njoftuar Policinë e Shtetit dhe duke bashkëpunuar me të.

**<u>Specifikimet për punonjësit e shërbimit (rojet), referuar Ligjit nr.75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike"</u>**

- Të jenë të aftë fizikisht;
- Të jenë të liçensuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut;
- Të jenë të pajisur me uniformë të rregullt (në bazë të nenit 23, të ligjit nr.75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" uniforma e punonjësit të shërbimit të SHPSF-së mbahet dhe përdoret vetëm gjatë kryerjes së shërbimit si dhe në uniformë duhet të vendosen, sipas përkatësisë, shenjat dalluese, emblemat, stemat, numri identifikues, të cilat tregojnë identitetin e subjektit dhe të punonjësit të shërbimit);
- Të jenë të pajisur me radio komunikimi dhe sistem qendror te komunikimit me radio;
- Te kenë të drejtën e mbajtjes e përdorimit të armëve sipas legjislacionit në fuqi si dhe të kenë leje për armë;
- Të zbatojnë me korrektësi detyrat për ruajtjen e objektit dhe të mbajë lidhje të vazhdueshme me drejtuesin teknik;
- Të mbajnë, sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e SHPSF-së, **vetëm gjatë kryerjes së detyrës**, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;
- Të kryejnë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që siguron;
- Të mos vendosin në uniformë dhe në mjetet e transportit simbole apo shenja të tjera, përveç atyre të miratuara nga ky ligj;
- Të ruajnë cilësitë morale, kodin etik për komunikim dhe sjellje qytetare, si dhe të mos përdorë pije alkoolike, droga e lëndë narkotike në shërbim.

Open Albania
Public Health Sector

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

| Objektet qe do te ruhen | Nr i Rojeve | Nr I vend | Nr i Turneve |
|---|---|---|---|
| Korpusi kryesor | 5 | 1 | 3 |
| Urgjenca | 5 | 1 | 3 |
| Godina | 5 | 1 | 3 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Sanatoriumit | | | |
| Poliklinika | 5 | 1 | 3 |
| Nr Total i rojeve | 20 | 4 | |

Afatet e ekzekutimit:

Ky sherbim do te realizohet per nje afat nga 16/02/2017 deri me 31.12.2017.

## TERMAT E REFERENCËS

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**PREVENTIV I SHPENZIMEVE PER 1 ROJE NE MUAJ me tre turne (turni I, II dhe III)**

| Nr. | Emërtimi i Shpenzimeve | Çmimi/Lekë |
|---|---|---|
| 1 | Paga bazë per nje punojes sherbimi | |
| 2 | Shtesë për sherbime | |
| 3 | **Shuma (1 + 2)** | |
| 4 | Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | |
| 5 | **Shuma (3 + 4)** | |
| 6 | Shpenzime për ndërlidhje | |
| 7 | Shepnzime armatimi | |
| 8 | Shpenzime për Uniformën | |
| 9 | Shpenzime administrative | |
| 10 | Fitimi i llogaritur | |
| 11 | **Shuma ne muaj per nje roje (5+6+7+8+9+10)** | |
| 12 | **Numri i vendrojeve** | |

| | | |
|---|---|---|
| 13 | **Shuma per periudhen 16 shkurt-31 dhjetor 2017** | |
| 14 | **TVSH** | |
| 15 | **TOTAL** | |
| | | |

Detyrat:

1. Te siguroje dhe te ruaje ambientet e Spitalit Rajonal Shkoder nga demtimet e mundshme.
2. Sherbimi i punonjesit te sherbimit do te jete me uniformen e caktuar.
3. Cdo vendroje do te jete i pajisur me armatim te domosdoshem dhe me pajisjet ndihmese qe percaktohen ne ligjet dhe udhezimet perkatese.
4. Punonjesit e sherbimit te jene te pajisur me mjete nderlidhje per komunikimin me SHRSF si dhe per parandalimin e ndalimin e veprimtarise se keqberesve ne dem te objektit qe ka nen ruajtje dhe nen pergjegjesine personale te tij.
5. Sherbimi i Ruajtjes e sigurimit fizik te objekteve do te jete 24 ore per cdo dite kalendarike sipas afateve te kontrates.
6. Pervec specifikimeve te mesiperme, marredheniet me te detajuara midis SHRSF dhe Spitalit do te jepen ne rregulloren e posaçme qe do te jete pjese perberese e kontrates.
7. Të mos lejojë parkimin e mjeteve para hyrjes kryesore të godinave spitalore;
8. Të mbështesë gjithmonë personelin infermieror sa herë kërkon ndihmë;
9. Gjatë gjithë kohës duhet personeli në shërbim, përveç veshjes duhet të mbajë dokumentin e identifikimit;
10. Të komunikojë me etikë si me qytetarët, pacientët ashtu dhe me personelin infermieror gjatë gjithë kohës së shërbimit.
11. Të mos lejojnë në mënyrë kategorike hyrjen e agjensive private funerale brenda shërbimeve spitalore .
12. Mundësia e vendosjes së penaliteteve, në varësi të moszbatim të pikave të mësipërme, kjo e vërtetuar dhe e dokumentuar, me proces verbalin përkatës, deri në prishjen e kontratës.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:
Korpusi Kryesor (Me te gjitha ambjentet) , Urgjenca, Poliklinike dhe Sanatoriumi.

Open Procurement Albania
Public Health Sector